



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KOMUNËS**

014-nr. 020/04-0196689/17, më 09.08.2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), nenit 5, pika 1 e Udhëzimit administrativ nr.22/2010, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e Komisionit për ndarjen e banesave, për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, veteranët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarët e tyre, të ndërtuara në parcelën kadastrale nr.584-3 me sipërfaqe prej 6869m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Çagllavicë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.
- II. Anëtarë të komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi, janë:
  1. Nazmi Cakolli , kryetar
  2. Munavere Qerkezi, anëtare
  3. Osman Bllaca, anëtar
  4. Ibrahim Morina , anëtar
  5. Bojamir Hoxha, anëtar
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi është të bëjë vlerësimin me pikë sipas kritereve të përcaktuara në bazë të Udhëzimit administrativ nr.21/2010 dt. 18.11.2010, për caktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**U dorëzohet:-**

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

69 AUG 2017

